

Marrëveshje Mirëkuptimi

Për shuarjen me kompensim të detyrimeve të prapambetura të disa Institucioneve Publike në Sektorin e Energjisë Elektrike

Lidhur ndërmjet

Ministritë së Financave,

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ministritë së Energjisë dhe Industrisë,

Ministritë së Mirëqenies Sociale dhe Rinise

CEZ Shpërndarje sh.a, dhe

KESH sh.a.

Duke patur parasysh se:

- a) Disa institucione buxhetore, si dhe institucione jo-buxhetore , kanë detyrime financiare të pa ekzekutuara ndaj shoqërisë CEZ shpërndarje sh.a. në formën e detyrimeve të papaguara, të faturave të energjisë elektrike në baze të kushteve kontraktuale dhe / ose parashikimeve ligjore. Në këto detyrime përfshihen edhe detyrimet e Ministritë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ndaj CEZ Shpërndarje të cilat që përfaqësohen nga rimbursimet e subvencioneve të energjisë elektrike ndaj invalidëve të realizuara nga CEZ Shpërndarje, detyrime të lindura para vitit 2011;
- b) Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. ka detyrime financiare ndaj KESH sh.a në formën e faturave të papaguara të energjisë së lëvruar për furnizimin e konsumatorëve apo mbulimin e humbjeve, në baze të kushteve kontraktuale dhe/ose parashikimeve ligjore;
- c) KESH sh.a ka detyrime ndaj Ministritë së Financave që rrjedhin nga detyrimet për ekspozimet e borxheve të akorduara;

- d) Palët në këtë marrëveshje kane qellim shuarjen me kompensim, konform parashikimeve të Nenit 514 të Kodit Civil, te detyrimeve reciproke në mes të institucioneve, shoqërive tregtare, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinise dhe KESH sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a të përmendura në këtë marrëveshje, pas rakordimit të plotë të detyrimeve reciproke te rena dakord ndërmjet palëve të interesuara ;
- e) Me qëllim shuarjen e detyrimeve te prapambetura me kompensim, në bazë të nenit 496 të Kodit Civil, Ministria e Financave merr përsipër te pranoje detyrimet dhe të zëvendësoje institucionet buxhetore dhe jo-buxhetore dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinise, të cilët janë debitorë të CEZ Shpërndarje sh.a. CEZ Shpërndarje sh.a pranon zëvendësimin e debitorëve sipas germës (e)
- f) Palët bien dakord dhe pranojnë transferimin pranë Ministrisë së Financave të kredisë (te drejtës) që KESH sh.a, ka ndaj CEZ Shpërndarje, në mënyrë që të bëhet e mundur shlyerja me kompensim e detyrimeve reciproke konform parashikimeve të Nenit 514 të Kodit Civil.

Për sa më sipër, në bazë të Nenit 496, Nenit 499 dhe Nenit 514 e në vijim të Kodit Civil , Palët në këtë Marrëveshje bien dakord si vijon:

1. Shuarja me kompensim do të përfshijë të gjitha detyrimet e përzgjedhura, te krijuara ndërmjet palëve deri në datën 31.12.2013, deri në shumën e detyrimit më të vogël. Detyrimet që kanë lindur pas kësaj date apo pagesat për detyrimet qe maturohen pas kësaj date, nuk janë pjesë e kësaj marrëveshje.
2. Palët bien dakord se do të rakordojnë detyrimet financiare të papaguara dhe/ose te paguara me vonese qe rezultojnë deri ne date 31.12.2013. Afati i fundit për të rakorduar detyrimet do jetë fundi i muajit Mars 2014, ose në rast se palët bien dakord për një datë tjetër, kjo nuk do jetë më vonë se data 15 Prill 2014.
3. Përfaqësuesit e institucioneve qendrore shtetërore që janë palë në këtë marrëveshje angazhohen te monitorojnë detyrimet e institucioneve te varësisë ndaj Shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, si dhe te bëjnë çdo përpjekje për sigurimin qe pagesat e ardhshme te behën ne kohe.
4. Gjithashtu, ne përputhje me angazhimet qe merren nga palët ne këtë Marrëveshje Mirëkuptimi, shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a merr përsipër te përmbushë te gjitha detyrimet qe lindin nga kjo marrëveshje, si dhe te mos krijoje detyrime te prapambetura pas datës 31.12.2013 ndaj shoqërisë KESH sh.a dhe OST sh.a.

I. Afati përfundimtar për realizim nga palët te akt-rakordimeve dhe saktësimin e detyrimeve financiare të papaguara dhe/ose te paguara me vonese qe rezultojnë deri ne date 31.12.2013, është data 31 Mars 2014

II. Në zbatim e kësaj Marrëveshje:

1. CEZ Shpërndarje sh.a, brenda datës 31.03.2014, paraqet tek Ministria e Financave detyrimet qe rezultojnë deri ne date 31.12.2013, te përditësuara deri në datën e nënshkrimit të marrëveshjes, për të gjitha institucionet buxhetore dhe jo- buxhetore, ndërmarrjet shtetërore, shoqëritë publike, aksionet e të cilëve janë në pronësi të agjencive dhe institucioneve shtetërore.
2. Palët në këtë marrëveshje do të ndërmarrin të gjitha përpjekjet për të përshpejtuar procesin e përgatitjes se akt rakordimeve.
3. Ministria e Financave operon për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Mirëkuptimi duke e konsideruar si përfundimtare listën e detyrimeve te prapambetura te dërguar nga shoqëria CEZ Shpërndarje.
4. Detyrimet e prapambetura, te përcaktuara nga shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a. për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rininë, në lidhje me kompensimin e energjisë elektrike të përfituar nga personat me aftësi të kufizuara (invalidë) do te konsiderohen përfundimtare nga Ministria e Financave;
5. CEZ Shpërndarje Sh.a., KESH Sh.a. marrin përsipër qe brenda datës 31.03.2014 te rakordojnë detyrimet e ndërsjella, të krijuara deri me date 31.12.2013, dhe të dorëzojnë akt-rakordimet përkatëse në Ministrinë e Financave, të cilat do të shuhen përkundrejt detyrimeve të prapambetura që KESH Sh.a. i detyrohet Ministrisë së Financave.
6. Ministria e Financave merr përsipër të zëvendësojë dhe përfaqësojë institucionet buxhetore dhe jo-buxhetore, si dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe të Rinise për detyrimet që këto të fundit kanë ndaj CEZ Shpërndarje sh.a., sipas akt rakordimeve përkatëse te hartuara ne zbatim te kësaj Marrëveshjeje.
7. Palët bien dakord dhe pranojnë transferimin pranë Ministrisë së Financave të kredisë (te te drejtës) që KESH sh.a, ka ndaj CEZ Shpërndarje , në mënyrë që të bëhet e mundur shlyerja me kompensim e detyrimeve reciproke.

8. Në përfundim të procesit të evidentimit dhe rakordimit të detyrimeve të ndërsjella sikurse përcaktohet më sipër, brenda datës 10.04.2014, midis palëve të kësaj Marrëveshje, do të nënshkruhet Marrëveshja finale e shuarjes me kompensim të detyrimeve.
9. Detyrimet deri ne datën 31.12.2013 të cilat mbeten të pa verifikuara nga palët ose janë në proces gjyqësor dhe për të cilat nuk është marrë një vendim gjykate, nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur palët kanë rënë dakord ndryshe;
10. Pretendimet e CEZ shpërndarje Sh.a. ne lidhje me procesin e privatizimit, do të zgjidhen midis KESH-it dhe CEZ Shpërndarje Sh.a edhe me miratimin e Ministrisë se Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në përputhje me procedurat përkatëse ligjore;
11. Kjo marrëveshje hyn ne fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave dhe nënshkrimin nga palët.

Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi hartohet ne 7 (shtatë) kopje, nga një për secilën pale nënshkruese dhe një kopje për Këshillin e Ministrave.

Tirane, meMars 2014